[Shqiptarja.com]

E enjte 17 Prill 2025 - Përditësimi i fundit 21:31

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJTËSI PUNËS SPECIALE LAJMËTË MIRA LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PHE E ZEZË SONDAZHE

Flash Sondazhi i Piepolit, 64% shqiptarëve nuk kanë aspak besim te opozita e udhëhequr nga Berisha

POP 5 Lajmet me të lexuara në 5 minutat e fundit

1 Ziliqi gjakun 24 ore deklaroi Ivi Kokaqi: Biti gentil ka qe, s'mbrojtëm asgjë, por s'kemi...

2 LIVE "Ethet e fushatës" Sondazhi i Piepolit ai Report Tv: 45% e shqiptarëve besojnë se Berisha me punë e qenësi Rama

3 Zgjedhjet/ Mësojnë emrat e para në Fier, 735 emigrantë kanë votuar, Ilirian Ziu: Rezultate Cakaun! Dal i vërtetë ngjyrosja kanë marrë zarfin

4 SHOKËRI! Sa paguhet LaCrisha nga Edi Berisha? Si paguhet? Ku janë faturat e pagesës? Dhe si shpjegohet qe SPAK, ai KGJI dhe ata Task Force-ash heshtin?

5 Trynoi në K2 18b, shumëm gjurmë në monitorët prej 72ë vite 8198 mësi nga Tahi Tahi

Kronikë

Lezhë/ Atentat në fshatin Pllanë, vritet babai i Roan Brahimit, autori zbriti nga 'Porche' dhe qëlloi me breshëri drejt lokalit të 64-vjeçarit (VIDEO)

Është vrarë me armë zjarri mbrëmjen e kësaj të enjtejë në fshatin Pllanë, babai i Roan Brahimit, të ekzekutuar më 9 maj 2024 në Vrona të Athinës.

- Pamje nga vendngjarja (VIDEO)
- Sot i vranë babanë, kush është Roan Brahimi! U ekzekutua 1 vit me parë në sy të gruas në Athinë

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

HOROSKOPI

Elvis Hila
17 Prill, 20:23 | Përditësimi: 17 Prill, 21:29

Share

LEZHË – Një ngjarje e rëndë kriminale ndodhi mbrëmjen e kësaj të enjtejë në fshatin Pllanë të Lezhës, ku është ekzekutuar me armë zjarri 64-vjeçari Gjovalin Prendi, banues në këtë zonë.

Krimi u regjistrua rreth orës 20:00 brenda lokalit në pronësi të viktimes në anë të rrugës nacionale Lezhë-Milot, në afersi të Ures së Matit.

Ndaj 64-vjeçarit u qëllua me breshëri plumbash, të cilat i shkaktuan vdekjen e menjëhershme.

LEXO EDHE:
Greqia prezanton strategjinë e hapësirës së saj detare, në hartë edhe ujërat e 'Çështjes së detit' me Shqipërinë

Gjovalin Prendi rezultoi të jetë babai, i Roan Brahimit të vrarë në muajin maj të vitit 2024 në një atentat mafiozi ne Athinë, ngjarje e cila vijon të jetë e pazbardhur. Nga veprimet paraprake hetimore, bëhet me dije se autorët janë larguar nga vendi i krimit me një mjet tip "Porche", ndërsa policia nuk ka arritur të bie ende në gjurmet e tyre.

Menjëherë pas sinjalizimit, forca të shumta të Policisë së Lezhës, të mbështetura edhe nga Forca Kombëtare e Sigurisë dhe Njësia Shkodër, kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë rrethuar zonën dhe po ushtrohen kontrolle.

Ndërkohë, është ngritur një grup i posaçëm hetimor që nën drejtimin e Prokurorisë ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje të rëndë.

Pista kryesore që po hetohet lidhet me hakmarrjen, pasi djali i viktimes Roan Brahimi apo i njohur edhe me emrin Sidorel Prendi dyshohet të ketë qenë i përfshire në ngjarje kriminale.

Gjovalin Prendi dhe Roan Brahimi

Lajmi po përditësohet...

Rendit zhvillimet sipas orarit: TË FUNDIT

Ora 21:16

Vrasja e babait të Roan Brahimit në Lezhë, pamje nga vendngjarja (VIDEO)

Report Tv sjell pamje nga vendi ku u ekzekutua me armë zjarri babai i Roan Brahimit, Gjovalin Prendi, 64-vjeçari u eliminua në lokalin e tij nga persona ende të paidentifikuar, ku i është bërë atentat edhe në vitin 2020.

Forca të shumta të Policisë kanë shkuar në vendin e ngjarjes të mbështetura nga Forca Kombëtare e Sigurisë, Njësia Shkodër.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 20:53

Sot i vranë babanë, kush është Roan Brahimi! U ekzekutua 1 vit me parë në sy të gruas në Athinë

Roan Brahimi

Roan Brahimi, i njohur edhe me emrin Sidorel Prendi nga Pllana e Lezhës, u ekzekutua me armë zjarri në një atentat mafiozi mbrëmjen e 9 majit 2024 në Athinë në sy të gruas dhe fëmijëve të tij.

Vrasja e Gentjan Bejtjes

Roan Brahimi dyshohet të ketë lidhje edhe me vrasjen Gentjan Bejtjes në 15 mars të këtij viti në Larushk të Krujës.

Një nga personat e arrestuar nga policia si transportues i vrasësve, Ilir Beqaraj, rezulton të ketë lidhje miqësore me të, konkretisht kunat me Roan Brahimin. Ky i fundit, në bashkëpunim me grupin e Niklës, ka dyshime të forta se kanë bashkëpunuar për të kryer këtë atentat, e po ashtu dyshohen të përfshirë edhe në disa ngjarje të fundit të ndodhura në Kurbin dhe Lezhë.

Ata mendohet të kenë qenë financues dhe organizator, për të godituar grupet rivale që i shihnin si rrezik për sigurinë e tyre. Për vrasjen e Gentjan Bejtjes dyshohet se paptuan qitës nga Vlora.

Vrasja e Brilant Martinajt (kushëriri i Ervis Martinajt)

Brahimi njihej edhe si armiku i Ervis Martinajt, 'mbretit të kumarit' i zhdukur pa gjurmë që prej 8 Gushtit 2022 në aksin Durrës-Shijak dhe fati i të cilit nuk dihet ende. Mbreti i Kumarit. Roan Brahimi dyshohet të jetë vrasësi i Brilant Martinajt, kushëririt të Ervis Martinajt.

Roan Brahimi alias Sidorel Prendi, njihet edhe si rival i Ervis Martinajt, pasi ishte i shpallur në kërkim për tu pyetur për vrasjen e Brilant Martinajt, (kushëriri i Ervis Martinajt) atentat që ndodhi në 17 korrik 2022, dhe u vranë dhe 2 të tjerë.

K.M/Shqiptarja.com

Share

K.M/Shqiptarja.com

TAG: lezhë roan brahimi gjovalin prendi prej prrallë Brilant Martinaj Ervis Martinaj

Komento

Komente

Ndalohet neptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH LIVE

Sondazhi i ditës: 17 Prill, 10:14
Fushata për 11 majin, a i besoni premtimet e partive politike?
Po Jo Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Lezhë/ Plagosja me thikë e 30-vjeçarit në Milot, arrestohet një nga vëllezërit e dyshuar, nën akuzë 2 agresorët e tjerë! Nën hetim edhe i dëmtuari, gjenjeu për ngjarjen
17 Prill, 15:28

Lezhë/ Blinin kanabis në sasi dhe e shisnin në doza, në pranga dhëndri në kërkim vjehrrit Sekuestrohen 34 kg lëndë narkotike (EMRAT)
17 Prill, 11:50

Sherr mes disa personave në Kurbin, njëri plagoset me thikë
16 Prill, 17:14

Petro Koçi: Berisha veproi për interesa greke! Më 11 Maj e kemi detyrim kombëtar të votojmë kundër tij dhe partisë çë komandon
16 Prill, 11:08

Rama ndan pamjet nga mruga e re Shëngjin-Velipojë: Një vlerë shtuar për Lezhën e Shkodrën turistike
16 Prill, 08:22

Botërori i shahut, Kler Çaku sërish protagoniste! Ndëron Shqipërinë në Greqi
Ernest Koçi
15 Prill, 19:18

'Plas' te Laçi, debate të forta dhe pezullime te kurbinasit! Skuadra nuk sërvitet prej ditësh
15 Prill, 12:29

Arratisja nga burgu i Shënkollit/ Laze 2 muaj i fshehur nëpër xhamitë e Tiranës, besimtarët i ofronin ushqimi! U kap teksa shkonte në banesë
Çukol Dema
15 Prill, 10:09

Një grup emigrantësh në Gjadër në 'protestë', shkatërrojnë mobilet e dhomave! Vihen në izolim (PAM,JET ME DRON)
Elvis Hila
14 Prill, 23:53

U arratis nga burgu i Shënkollit, arrestohet pas 2 muajsh Daut Laze, u kap në rrugë afër shtëpisë në Astir
14 Prill, 22:28

'Njerka e pa abuzimin dhe nuk tregoi'/ 14 vite burg për babanë që vrau përdhunuesin e të bijës, i afërmi: Zbulime trondëtëse në gjyq
14 Prill, 20:48

Zgjedhjet/ Socialdemokratëve të Tom Doshit i firosjnë 2 kandidatë për deputetë në Lezhë, dorëhiqen Stojani e Trokthi! Shkon në 17 numri i të tërhequrve
14 Prill, 18:02

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kësaj faqeje